



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM

Nr. 176, datë 05.05.2022

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Kultivimi i bimëve narkotike”, kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenin 284/2 të Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje e energjisë elektrike” neni 137/1 i Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Kanosje” kryer në bashkëpunim, “Plagosje e lehtë”, etj., nenet 278/1, 84-25 dhe 89-25 të Kodit Penal.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria Krujë; E pandehur: {...}; Objekti: Dërgim në gjyq.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Objekti: Dërgim në gjyq.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...} etj; Objekti: Dërgim në gjyq.

7. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 283/1, 286/1, 114/2 dhe neni 29/1 të Kodit Penal. Kryesuesi/Relatori i kësaj çështjeje gjyqësore do të zgjidhet sipas shortit midis dy gjyqtarëve aktualë, ndërsa gjyqtari i shortuar Olti Skrame nuk do të jete në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të çështjes.

8. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, {...} etj; Objekti: Detyrim njohje pronar.

9. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Heqja e zotësisë për të vepruar.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ilir Përdeda, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 140 dhe 25 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Suela Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, më shumë se njëherë, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 284/2 të Kodit Penal.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ilir Përdeda, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen civile me: Paditëse e kundër paditur: {...}; I paditur: {...} Tiranë, etj.; I paditur kundërpaditës: {...}, etj.; Person i tretë: {...}; Objekti: “Detyrimin e palëve të paditura të më njohin pronar si trashëgimtar i babit tim Besim

Shehu në pronën e ndodhur në qytetin Peshkopi, etj.”; Objekti i kundërpadisë: “Pavlefshmërinë e vendimit nr.126, datë 13.07.2000 të KKKP-së pranë Këshillit të Qarkut Dibër, etj.”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Seladin Pysqyli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Objekti: Kërkesë për pushimin e çështjes penale.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Seladin Pysqyli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Shpallje të zhdukur të shtetasit {...}.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Seladin Pysqyli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Shpallje të zhdukur të shtetasit {...}.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Florin Demollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen penale me të pandehur: Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje” dhe “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit” parashikuar në nenet 134/2 dhe 323 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Blerta Marku (Çibuku), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur {...} dhe {...}; Akuza: “Prodhim shitje narkotikes” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË DURRËS

1. Gjyqtaret e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Afërdita Maho dhe Enerjeta Shehaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, çështjen administrative me Paditës: {...} sh.p.k, etj.; Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Konstatimin e pavlefshmërisë së akteve administrative të Këshillit Bashkiak Prrenjas, etj.”

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen administrative me Padi të: {...}; E paditur: {...} Objekti: “Konstatimin e paligjshmërisë së aktit administrativ vendim nr.140, datë 12.07.2017, njoftuar me shkresën nr.2466 prot., datë 17.07.2017, si pavlefshmëri absolute, shfuqizimin e tij dhe rregullimin e pasojave të arshura, si dhe pagesën e shpenzimeve gjyqësore në ngarkim të palës së paditur, sipas legjislacionit në fuqi”.

2. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen administrative me Padi të: {...}; Të paditur: {...}; Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër; Objekti: “Detyrimin e të paditurve për të trajtuar me pagesë kalimtare në masën 50% të pagës referuese mujore e shtrirë në një periudhë kohe 2 vjeçare dhe si shpërblim të menjëhershëm me masën e dy pagave referuese mujore dhe njohjen e kësaj periudhe si vjetërsi shërbimi për efekt të pensionit të plotë të pleqërisë”.

3. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen administrative me Padi të: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Marrjen e masës së sigurimit të padisë. Deklarimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, vendimit nr.176, datë 17.05.2019 të IKMT-së, etj.”.

4. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen administrative me Padi të: {...}; I paditur: {...}, etj.; Objekti: “Marrjen e masës së sigurimit të padisë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, lejes së ndërtimit nr.1/5, 06.02.2010 të dhënë nga {...}, etj.”.

5. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen administrative me Padi të: {...}”; E paditur: {...}; Objekti: “Marrjen e masës së sigurimit të padisë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendimit të kontabilizimit nr.12, me nr.151 prot., datë 29.06.2012 të Degës së Doganës Tre Urat Përmet, etj.”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 139, 25-22 i Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR